



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 84/2 Prot.

Tiranë, më 13 01 2026

V E N D I M

Nr. 8 dt. 13.01 2026

“PËR

**NISJEN E PROCEDURAVE PËR HAPJEN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT
“MASTER I SHKENCAVE” NË ‘REHABILITIM TË PROFESIONEVE TË
SHËNDETIT”, ME DIPLOMË TË DYFISHTË, MIDIS UNIVERSITETIT TË
SPORTEVE TË TIRANËS, FAKULTETI I SHKENCAVE TË REHABILITIMIT DHE
UNIVERSITETIT TË KATANXAROS “MAGNA GRECIA” NË ITALI DHE
MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR PROGRAMIN”**

Mbështetur në nenin 3, 38 dhe 80 të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr. 57 datë 29.01.2020 “Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës”, Udhëzimin nr. 1, datë 14.1.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njësisve kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e institucionit të arsimit të lartë”, i ndryshuar, në nenin 7, 20, 73 të Statutit të UST-së, në nenin 7, 54 dhe 55 të Rregullores së UST-së, shkresën nr. 76/2 prot., datë 12.01.2026 prot., datë 07.01.2026 të Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit “Nisja e procedurave për hapjen e programit të studimit të ciklit të dytë Master Shkencor në “Rehabilitim të Profesioneve të Shëndetit”, me diplomë të dyfishtë në bashkëpunim me Universitetin e Katanxaros “Magna Grecia” në Itali, pranë Fakultetit të Shkencave të Rehabilitimit”, Senati në mbledhjen e datës 13.01.2026,

V E N D O S I :

1. Miratimin e nisjes së procedurave për hapjen e programit të përbashkët “Master i shkencave” në “Rehabilitim të profesioneve të shëndetit”, me diplomë të dyfishtë, midis Universitetit të Sporteve të Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit dhe Universitetit të Katanxaros “Magna Grecia” në Itali.
2. Miratimin e marrëveshjes së bashkëpunimit për programin e përbashkët me Universitetin e Katanxaros “Magna Grecia” në Itali (bashkëlidhur vendimit).
3. Ky Vendim i përcillet Bordit të Administrimit.

4. Ky Vendim i përcillet për njohje dhe zbatim FSHR-së, si dhe Drejtorisë Së Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikim.
5. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof. Dr. Agron KASA

